

AKTI I THEMELIMIT TE SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

"HOTEL COLOMBO BERAT" SH.P.K.

Neni 1

Themelohet shoqeria tregtare me pergjegjesi te kufizuar "HOTEL COLOMBO BERAT" sh.p.k. mbeshtetur ne ligjin Nr. 9901, date 14.4.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" te ndryshuar, ligjin Nr. 9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", ligjin Nr. 9121, date 28.7.2003, "Per Mbrojtjen e Konkurrences", Kodin Civil dhe Kodin e Punes, me ortak te vetem themelues si vijon:

Shoqëria **UFO SH.P.K me nr. NUIS J82025002B** me adresë në Bulevardi "Zogu i Pare, ish Pallati i Kultures "Ali Kelmendi".

Neni 2

Ortakët e shoqërisë

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj në përputhje me Statutin dhe legjislacionin shqiptar.

Neni 3

Forma ligjore

Shoqëria ka formën e "shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar" ose "SHPK". Megjithatë, ajo mund të shndërrohet në një formë tjetër në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Neni 4

Kohëzgjatja e veprimtarisë

Afati i veprimtarisë së Shoqërisë është i **pacaktuar**. Ky afat fillon nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Neni 5

Selia

- 5.1 Selia e Shoqërisë do të jetë në adresën: **Hotel Colombo Berat, Rruga "Santa Luçia", lagja nr. 2, Ndërtesa nr. 6, Berat.**
- 5.2 Shoqëria mund të hapë degë dhe/ose zyra përfaqësie, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera shqiptare dhe/ose të huaja, që ekzistojnë ose do të krijohen në të ardhmen.

Neni 6

Dokumentet e shoqërisë

- 6.1. Të gjitha shkresat, formularët e urdhrave apo çdo dokument tjetër korrespondence, nxjerrë nga shoqëria, degët apo zyrat e përfaqësimit, nëpërmjet përdorimit të letrës ose mjeteve elektronike, të cilat u drejtohen palëve të treta, duhet të përmbajnë, përveç emrit të shoqërisë edhe të dhënat e mëposhtme:
- a) *numrin unik të identifikimit;*
 - b) *formën ligjore të shoqërisë;*
 - c) *vendndodhjen e selisë së regjistruar dhe të zyrës qendrore të saj;*
 - ç) *të dhëna nëse shoqëria është në likuidim;*
 - d) *vlera e kapitalit të regjistruar të shoqërisë dhe vlera e pjesës së paguar të kapitalit;*
- 6.2. Nëse shoqëria ka faqe interneti, këto të dhëna duhet të pasqyrohen aty.

Neni 7

Objekti i veprimtarisë

- 7.1 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë:
- *Ofrim i shërbimeve në fushën e hotelerisë, menaxhimi i hoteleve, godinave dhe ambienteve në të cilat ushtrohet aktiviteti hotelier.*
 - *Hapja dhe menaxhimi i sallave të konferencave, hapësirave të fitnessit, pishinave, qendrave të dërmo-estetikës, bareve, restoranteve, qendrave të këmbimit valutor në kuadër të aktivitetit hotelier dhe brenda strukturës hoteliere.*
 - *Ushtrimi i aktiviteteve në fushën e turizmit dhe të udhëtimeve dhe të transportit turistik, organizimin e udhëtimeve dhe pushimeve individuale ose kolektive për shtetasit shqiptar dhe të huaj brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, përfshirë këtu edhe ndërmjetësimin e shërbimeve të të tretëve për vizitorët në Republikën e Shqipërisë, të tilla si por pa u kufizuar në, hotelerinë, gastronominë, kulturën, shëndetin, stomatologjinë, sportin, muzikën etj.*

- *Ushtrimi i veprimtarisë turistike si: operator turistik/ agjenci turistike udhëtimi, të transportit për udhëtarë, guidave të ndryshme;*
- *Ushtrimi i veprimtarisë për shitje biletash të të gjitha llojeve të transportit ajror, detar, tokësor, hekurudhor.*
- *Ofrim shërbimi parkimi dhe lavazhi.*
- *Ushtrimi i aktiviteteve në fushën e pasurive të paluajtshme, ndërmjetësim për shitblerje dhe qira të pasurive të paluajtshme, studime dhe analiza për tregun e pasurive të paluajtshme, raporte vlerësimi për pasuri të paluajtshme - konsulencë ligjore dhe teknike në fushën e pasurive të paluajtshme.*

7.2 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë mund të ndryshohet ose shtohet me vendimin e Asamblesë së ortakëve.

Neni 8

Kapitali themeltar

- 8.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është ALL 100.000 (njëqind mijë lekë).
- 8.2 Kapitali ndahet në 1 (një) pjesë/kuotë.
- *Ortaku, shoqëria UFO SHPK, zotëron 100% të kapitalit themeltar, ose 1 (një) pjesë/kuotë, me vlerë nominale 100.000 ALL (njëqind mijë lekë).*

Neni 9


Transferimi i pjesëve të kapitalit

- 9.1 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve. Kapitali themeltar është lirisht i transferueshëm në rast trashëgimie, në rast ndarje pasurore mes bashkëshortëve apo paraardhësve e pasardhësve.
- 9.2 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme tek të tretët, qofshin këta subjekte shqiptarë apo të huaj, persona fizikë apo juridikë.

Neni 10

Zmadhimi/zvogëlimi i kapitalit

- 10.1 Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit të Shoqërisë mund të bëhet me vendim të Asamblesë së ortakëve si dhe në përputhje me kërkesat ligjore.




10.2 Ortakët, me kërkesë të thjeshtë të administratorëve, në mënyrë unanime dhe në përpjesëtim të drejtë të kuotave që posedojnë, mund të përmbushin nevojat financiare të shoqërisë nëpërmjet rritjes së kapitalit ose financimeve (qofshin këto me fitim/interes ose jo), duke respektuar normat e transparencës bankare dhe kërkesat të tjera me karakter fiskal. Rimbursimi i derdhjeve dhe i financimeve të ortakëve mund të bëhet me vendim të ortakëve, siç, me të njëjtat modalitete mund të destinohen për mbulimin e humbjeve eventuale ushtrimore.

Neni 11

Asambleja e Ortakëve

- 11.1 Asambleja e Ortakëve përbëhet nga ortakët e shoqërisë. Ajo drejtohet nga administratorët e shoqërisë ose nga çdo person tjetër i zgjedhur nga ortakët.
- 11.2 Asambleja e ortakëve ka këto kompetenca kryesore:
- ndryshimi i dispozitave të statutit,
 - zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit,
 - emërimi dhe ndryshimi i administratorëve, likuiduesve dhe ekspertit kontabël,
 - miratimi i shpërblimeve të administratorëve, likuiduesve dhe ekspertit kontabël,
 - miratimi i llogarive vjetore (bilancit),
 - ndryshimi i formës ligjore të shoqërisë,
 - mbyllja dhe shpërndarja e parakohshme shoqërisë si dhe të tjera të përcaktuara në legjislacionin shqiptar tregtar në fuqi.
- 11.3 Asambleja e ortakëve mblidhet të paktën një herë në vit dhe sa herë që duhet të vendosë për çështje të kompetencës së saj. Mbledhja mund të realizohet edhe nëpërmjet video-konferencës.
- 11.4 Mbledhja e Asamblesë thirret nga Administratorët ose nga ortakët që përfaqësojnë të paktën 5% të kapitalit themeltar. Asambleja thirret me anë të një njoftimi me shkrim që u dërgohet ortakëve të paktën shtatë ditë përpara datës së mbledhjes. Njoftimi mund të dërgohet edhe nëpërmjet postës



4

elektronike por në çdo rast duhet të përmbajë ditën, orën, vendin si dhe rendin e ditës me çështjet që do të trajtohen.

- 11.5 Ortakët mund të përfaqësohen në mbledhje nga persona të tjerë, bazuar në një prokurë të lëshuar paraprakisht, prej tyre.

Neni 12

Vendimmarrja

- 12.1 Në rastin e marrjes së vendimeve që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e ortakëve mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote që zotërojnë më shumë se 30% të kapitalit të shoqërisë.
- 12.2 Në rastin e marrjes së vendimeve që kërkojnë një shumicë të kualifikuar, asambleja e ortakëve mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote që zotërojnë më shumë se 50% të kapitalit të shoqërisë.
- 12.3 Asambleja e shoqërisë, vendos me 75% të kapitalit pjesëmarrës (të përfaqësuar nga ortakët), siç parashikohet në pikën 12.2 më sipër, për ndryshimin e statutit, zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë. Në rastet e tjera, asambleja e shoqërisë, vendos me më shumë se 50% të votave të ortakëve pjesëmarrës në mbledhje.
- 12.4 Të gjitha vendimet e Asamblesë duhet të regjistrohen në një procesverbal, ku shënohet data, vendi, rendi i ditës, emri i drejtuesit të mbledhjes dhe mbajtësit të procesverbalit, çështjet kryesore dhe vendimet e marra. Procesverbali nënshkruhet nga Kryetari dhe Sekretari (mbajtësi i procesverbalit).

Neni 13

Administrimi

- 13.1. Administrimi i Shoqërisë bëhet nga 2 (dy) administrator, Administratori Ekonomik dhe Administratori Ekzekutiv. Administratorë të cilët kanë kompetenca të ndara, si dhe të drejta dhe detyrime të përbashkëta në përputhje me kompetencat, të drejtat dhe detyrimet që i jep ligji, ky Statut, vendimet e


Asamblesë së përgjithshme dhe rregullat e brendshme të administrimit të Shoqërisë.

13.2. Administratorët emërohen për një mandat 5 (pesë) vjeçar. Administratorët zëvendësohet ose shkarkohet nga kjo detyrë me vendim të Asamblesë së ortakëve. Mandati është i rinovueshëm.

13.2.1 Administratori **ekonomik** përfaqëson e vetme dhe në mënyrë ekskluzive shoqërinë dhe vepron në emër dhe për llogari të saj, duke pasur kompetencat e mëposhtme:

- a) hapjen e llogarive bankare të Shoqërisë pranë bankave brenda dhe jashtë vendit;
- b) lëshimi dhe marrja e urdhër-pagesave
- c) nënshkrimin e të gjithë akteve financiare, nxjerrjen e faturave, transferimet në monedhë të huaj, fletë-ngarkesat etj., pagimin e detyrimeve të Shoqërisë;
- d) mbledhjen e detyrimeve që i takojnë Shoqërisë, dhënien dhe marrjen e paradhënies;
- e) është përgjegjës për mbajtjen e llogarive në përputhje me ligjin;
- f) publikimin e shpalljeve të nevojshme përfshirë dhe publikimin e pasqyrave vjetore financiare;
- g) Veprimet bankare të shoqërisë, duke përfshirë por pa u kufizuar në to, hapjen dhe mbajtjen e llogarive bankare, transfertat bankare, tërheqjen e shumave që lidhen me aktivitetin e Shoqërisë.
- h) Si dhe çdo veprim tjetër të nevojshëm që përfshin anën financiare të shoqërisë pa përjashtuar edhe bankat.

13.3 Administratori **ekzekutiv** përfaqëson shoqërinë dhe vepron në emër dhe për llogari të saj në lidhje me të gjitha veprimet administrative dhe juridike të shoqërisë. Administratori ekzekutiv nuk ka kompetencë të përfaqësojë shoqërinë dhe të veprojë në emër dhe për llogari të saj në lidhje me veprime që përfshijnë anën financiare të shoqërisë pa përjashtuar edhe bankat dhe kompetencat e përcaktuara më lart për Administratorin ekonomik



6

- 13.4 Administratorët janë përgjegjës për të gjitha veprimet e kryera prej tyre përpara Shoqërisë, ortakëve të saj, si dhe të tretëve për dëmet që mund t'u vijnë atyre nga veprimet apo mosveprimet e tyre.
- 13.5 Administratorët kanë kompetenca diskreciale për veprimet e përditshme të administrimit të Shoqërisë. Në kuptim të kësaj dispozite, Administratorët veçmas dhe/ose së bashku mund të kryejnë lirisht veprime të cilat ligji dhe Statuti nuk ia njohin në mënyrë të shprehur Asamblesë së përgjithshme, me kushtet që:
- a. këto veprime të lidhen vetëm me kompetencat e administrimit dhe jo të vendimmarrjes,
 - b. këto veprime të synojnë realizimin e objektit të Shoqërisë,
 - c. këto veprime të jenë dhe të kryhen në mënyrë të ligjshme.
- 13.6 Administratorët veçmas dhe/ose së bashku kanë të drejtat, detyrat dhe kompetencat e mëposhtme:
- a. janë të autorizuar të përfaqësojnë Shoqërinë në të gjitha çështjet që kanë lidhje me të kundrejt palëve të treta dhe shtetin;
 - b. dhënien me qira të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme të shoqërisë;
 - c. përgatitjen e pasqyrave vjetore financiare të Shoqërisë dhe kontrollin e tyre nga një auditor i jashtëm nëse diçka e tillë kërkohet nga ligji apo vendimi i Asamblesë së përgjithshme
 - d. punësimin dhe shkarkimin e personelit të Shoqërisë, përcaktimin e pagave, shpërblimeve dhe pagesave të tij;
 - e. marrjen e masave paraprake për mbrojtjen e interesave të Shoqërisë, ngritjen e padive dhe marrjen përsipër të mbrojtjes së Shoqërisë në rast të padive kundër saj;
 - f. udhëzimin e avokatëve/juristëve për mbrojtjen e interesave të Shoqërisë dhe përcaktimin e shumës së shpërblimit të tyre;
 - g. ngritjen e padive dhe tërheqjen e tyre, nënshkrimin e marrëveshjeve gjyqësore, nënshkrimin e marrëveshjeve të arbitrazhit, caktimin e arbitrave;

- h. Administratorët kanë të drejtë marrin çdo vendim tjetër që i takon aktivitetit të përditshëm të Shoqërisë nga pikëpamja e ligjit dhe këtij Statuti dhe që nuk përfshihet në kompetencat ekskluzive të njërit administrator;
 - i. thirrjen e Asamblesë së përgjithshme, përcaktimin e rendit të ditës, monitorimin e përmbushjes së dispozitave që kanë lidhje me thirrjen dhe drejtimin e Asamblesë së përgjithshme për shpalljen e vendimeve të veçanta;
 - j. është përgjegjës për mbajtjen e rregullt dhe ruajtjen e dokumentacionit të Shoqërisë;
 - k. merr vendime mbi të gjitha çështjet e tjera që lidhen me aktivitetin e brendshëm të Shoqërisë dhe marrëdhëniet e saj të jashtme;
 - l. Administratori mund të autorizojë palë të treta që ta përfaqësojnë Shoqërinë në transaksione të veçanta që janë në kompetencën e tij;
- 13.7 Administratorët bazuar në një vendim të asamblesë së ortakëve, mund të emërojnë drejtorë, përfaqësues me prokurë dhe të mandatuar të përgjithshëm për veprime të caktuara ose kategori veprimesh.
- 13.8 Administratorët i shoqërisë nuk mund të shesë dhe/ose blejë pasuri të paluajtshme në emër dhe për llogari të shoqërisë, pa marrë më parë miratimin paraprak me shkrim të asamblesë së ortakëve.
- 13.9 Administrator Ekonomik do të jetë *Znj. Adelina Veliaj, atesia Kristo, shtetase shqiptare, lindur me 26.12.1971, ne Permet dhe banuese ne Tiranë, Rruga "Jul Variboba", Vila Nr. 2, madhore e me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtese e leternjoftimit me numer personal H16226128P dhe*

Administrator Ekzekutiv do të jetë *Znj. Anisa Veliu, atësia Muhamet, shtetase shqiptare, lindur në Berat më datë 22.02.1986, dhe banuese në Berat, Lagja 30-vjetori (pranë tregut industrial), mbajtëse e letërnjoftimit me Nr. Personal I65222070F,*



8

Kontrolli financiar

Asambleja e Ortakëve mund të emërojë një apo disa ekspertë kontabël të cilët kanë detyrën të kryejnë kontrollin kontabël dhe financiar të shoqërisë.

Neni 15

Viti financiar

- 15.1 Viti financiar i Shoqërisë përputhet me vitin kalendarik, duke filluar nga 1 Janari dhe përfundon më 31 Dhjetor të çdo viti.
- 15.2 Si përjashtim, viti i parë financiar i veprimtarisë së Shoqërisë fillon nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Neni 16

Bilanci dhe Dividendët

- 16.1 Në fund të vitit ushtrimor, administratori, merr masa për përgatitjen e bilancit. Bilanci u paraqitet ortakëve për miratim, brenda afateve ligjore.
- 16.2 Asambleja e ortakëve që miraton bilancin vjetor, vendos mbi shpërndarjen e fitimit ortakëve ose krijimin e rezervave si dhe krijimin e rezervave ligjore.
- 16.3. Deri në shlyerjen e investimit fillestar, ortakët bien dakord që në rast se shoqëria do të realizojë një fitim vjetor, nga shpërndarja e dividendëve përkatës do të përfitojnë vetëm ortakët që zotërojnë respektivisht nga 30% të kuotave. Më pas dividendët do tu shpërndahen të gjithë ortakëve të shoqërisë, proporcionalisht me përqindjen e zotërimit të kuotave.

Neni 17

Likuidimi dhe prishja

Likuidimi dhe prishja e shoqërisë vendoset dhe kryhet në përputhje me kërkesat ligjore.

Neni 18

Dispozita mbyllëse

Ky Akt themelimi hartohet në dy ekzemplarë në gjuhën shqipe, me fuqi të njëjtë ligjore.



ORTAKU I VETËM
SHOQËRIA "UFO" SHPK
përfaqësuar nga
znj. Amanda Gjyli

Data. 18. 01. 2021

Amanda Gjyli

